



BASHKIA
TIRANË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

23.07.2021

Drejtuar: “NDREGJONI” sh.p.k.

Adresa: Rruga “Sule Bega”, Ndërtesa Nr.32, Hyrja Nr.8, Tiranë

Procedura e prokurimit/lotit: “Rikonstruksion i ambjenteve të Klinikës Veterinare”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-00381-07-07-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Rikonstruksioni i ambjenteve të brendshme të Klinikës Veterinare me kohëzgjatje kontrate 40 (dyzetë) ditë kalendarike nga nënshkrimi i kontratës.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “INERTI” sh.p.k.

J66926804L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 3,715,691.94 (tre milion e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një pikë nëntëdhjetë e katër) lek pa TVSH dhe 4,458,830.33 (katër milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë pikë tridhjetë e tre) lek me TVSH.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. “NDREGJONI” sh.p.k.

K31329048I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 3,649,766 (tre milion e gjashtëqind e dyzetë e nëntë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lek pa TVSH dhe 4,379,719.2 (katër milion e treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë pikë dy) lek me TVSH.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “INERTI” sh.p.k.

J66926804L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Arsyet e mëposhtme:

1. Shtojca 8, pjesa e pajisjeve të punës deklaruar “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” tek faturat një pjesë është shënuar vetëm numri faturës dhe jo data e faturave (kjo për efekt verifikimi në vijim këto dy të dhëna tek faturat e blerjes janë domosdoshmëri).
2. Nuk është paraqitur deklarata në lidhje me stafin që kërkohet sipas formatit të kërkuar.
3. Nuk është paraqitur deklarata në lidhje me makineritë / pajisjet që disponon sipas formatit të kërkuar.
4. Për materialet e pajisjet elektrike është paraqitur autorizim nga Sali Elektrik i datës 05.04.2017, i cili është distributori zyrtar i produkteve elektrike të prodhuara nga kompania ICEL SCPA, autorizim ky i datës 15 Janar 2016. Janë paraqitur skedat teknike të produkteve elektrike të firmës ICEL SCPA të pa përkthyer në gjuhën shqipe, duke mos identifikuar as se cilat janë produktet e kërkuara dhe as specifikimet teknike të kërkuara. Dokumentat Standarde të Tenderit janë të hartuara në gjuhën shqipe dhe çdo dokumentë i paraqitur duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe.
5. Operatori ekonomik ka paraqitur për llaç i gatshëm suvatimi kontratë furnizimi me “ÇANAKU” sh.p.k. , datë 01.01.2018, i cili është distributori zyrtar i produkteve të prodhuara nga kompania RENOVA, vërtetim ky i datës 05.04.2017. Nuk është paraqitur asnjë katalog ose fragmente të katalogu të prodhuesit ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi, ku të tregohen dhe të

specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi.

6. Për mallrat objekt prokurimi për të cilat kërkohen standarte kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara (të pasqyruara në shtojcën e Specifikimet Teknike), nuk janë paraqitur certifikatë/deklaratë konfirmimit CE të prodhuesit të konfirmuar nga një organizëm i notifikuar europian/organizëm çertifikues i akredituar ose raportet e testimit nga organizëm i notifikuar europian/ laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara.
7. Tabela për 19 artikujt e kërkuar nuk është plotësuar sipas formatit të kërkuar për arsyet e mëposhtëme:
 - Në kolonën e tretë ku kërkohen specifikimet teknike referuar katalogëve/prospekteve dhe nr. i faqes së katalogëve për çdo artikull etj, kjo kolonë paraqitet me shënimin ”sipas katalogut” duke krijuar vështirësi në vlerësimin e anës teknike të produkteve, për më tepër që dokumentat janë në anglisht.
 - Për produktin me Nr.1 emri i kompanisë prodhuese duhet të jetë Renova ajo që prodhon produktet referuar dhe vërtetimit të paraqitur.
 - Për produktin me Nr.19 mungon dhe emri i kompanisë prodhuese.
 - Për produktet ku sipas tabelës prodhues është Sali Elektrik nuk është paraqitur asnjë katalog ose fragmente të katalogu të prodhuesit ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi.
8. Certifikata ISO 9001:2015 për “Sistemin e menaxhimit të cilësisë” nuk është më e vlefshme, pasi i ka mbaruar afati më 05.06.2021.
9. Certifikata OHSAS 18001-2007 për “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” nuk është më e vlefshme, pasi i ka mbaruar afati më 05.06.2021.
10. Certifikata ISO 14001-2015 ose ekuivalente për “Sistemin e menaxhimit të mjedisit” nuk është më e vlefshme, pasi i ka mbaruar afati më 05.06.2021.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “NDREGJONI” sh.p.k. me adresë Rruga “Sule Bega”, Ndërtesa Nr.32, Hyrja Nr.8, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale 3,649,766 (tre milion e gjashtëqind e dyzetë e nëntë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lek pa TVSH dhe 4,379,719.2 (katër milion e treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë pikë dy) lek me TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Rudina Hoxha